



# Zëri i Grave Kosovare

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

## RrGGK Kërkon Mbështetje për të Mbijetuarat e Dhunës Seksuale

Human Rights Watch ka vlerësuar se rreth 20,000 persona janë dhunuar gjatë luftës së viteve 1998-1999 në Kosovë. Dhuna seksuale e kryer në luftë përbën krim të luftës, krim kundër njerëzimit dhe akt themelor të gjenocidit, sipas Rezolutës 1820 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara mbi Dhunën Seksuale kundër Civilëve në Konflikt.

Bosnia ka njohur të mbijetuarit e dhunës seksuale si "viktima" zyrtare të luftës, gjë që ka lehtësuar marrjen e përfitimëve nga ta dhe shërimin e tyre. Megjithatë, të mbijetuarit e dhunës seksuale në Kosovë ende presin vëmendjen e mjaftueshme. Çështja e dhunës seksuale nuk është konsideruar në negociatat në mes të Kosovës dhe Serbisë. Zyrtarët serb asnjëherë nuk kanë kërkuar falje për këto krime, e as nuk ka pasur ndonjë dënim apo dëmshpërblim. Për më tepër, shoqëria i ka izoluar dhe ka dështuar t'i mbështes gratë që kanë vuajtur dhunë të tillë. Shumë gra kanë provuar që të vazhdojnë me jetën e tyre pa trajtim psikologjik. Provat e mbledhura nga organizatat e grave sugjerojnë që kjo ka kontribuar në trauma, fobi, frenime në dëshirën seksuale dhe çrregullime të ngrënies, si dhe dëmtime fizike të patrajtuara.

Gratë që kanë vuajtur dhunë seksuale kërkojnë që të futen në mes të kategorive të personave të prekur nga lufta. Kjo do të ofronte njohje, fund të stigmatizimit dhe kthim të dinjitetit. Pasi që dhuna seksuale është përdorur si armë e luftës, armë lufte, atëherë gratë duhet të trajtohen si të gjitha viktimat e luftës.

Më 8 Mars 2012, RrGGK organizoi protestën me moton: "Nuk duam lule por duam drejtësi për gratë e dhunuara gjatë luftës", përmes së cilës RrGGK kërkoi mbrojtje ligjore për gratë e dhunuara gjatë luftës.

Duke pasuar më shumë se një vit të punës avokuese intenzive që *bashkoi gratë e shoqërisë civile dhe gratë në politikë, më 14 mars 2013, Kuvendi i Kosovës miratoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, personave të dhunuar gjatë luftës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre.*

Ky akt historik ofroi një fije shpresë për gratë që përjetuan dhunë seksuale.

Megjithatë, leximi i parë kaloi me një diferencë të ngushtë (tre vota). Disa deputetë deklaruan se nuk ka burime të mjaftueshme financiare për ta mbështetur atë. RrGGK i sheh këto argument si të pabaza. Statistikat nga Bosnja sugjerojnë që edhe pse numri i përafërt i viktimave të dhunuara gjatë luftës atje ishte rreth 60,000, vetëm 900 kanë aplikuar për përfitime financiare. RrGGK ka shkruar letra të ndryshme, së bashku me grupe të tjera të shoqërisë civile, duke kërkuar nga deputetët që të kalojnë këtë amendamentim të rëndësishëm, për t'iu kthyer dinjitetin grave që kanë vuajtur mjaft.



### Bashkangjitu me ne!

**Takimi i Rregullt i RrGGK**  
8 prill 2013, 11:00,  
Restorant Iliria, Gjakovë

### Në këtë numër:

**RrGGK Dënon Sulmin ndaj**  
**Aktivistes Nazlie Bala....2**

**Qytetarët Protestojnë**  
**Vërejtjet Seksiste të**  
**Parlamentarëve.....2**

**Dhuro Jetë: Dhuro Gjak,**  
**RrGGK Shënon 8 Marsin...**  
.....3

**RrGGK Mbledh Grupin e**  
**Fuqizimit Ekonomik....4**

**Anëtarët Marrin Pjesë në**  
**Punëtorinë e Shkrimit të**  
**Projekt Propozimeve.....4**



**Faqja në Facebook**  
**Grupi në Facebook**



**Lista e dërgesave të**  
**E-Lajmeve**



Që nga protesta e 8 Marsit e RrGGK-së, qytetarët kanë avokuar zëshëm për të drejta ligjore për gratë që kanë vuajtur dhunë seksuale gjatë luftës.

## RrGGK Dënon Sulmin ndaj Aktivistes Nazlie Bala

Më 27 mars 2013 rreth orës 20:35, Aktivistja për të Drejtat e Njeriut Nazlie Bala është sulmuar fizikisht në hyrjen e banesës së saj. Ajo pastaj ishte kërcënuar: “Dije se kemi me të vra.” Ky sulm erdhi pasi Bala më 20 Mars kishte pranuar një letër anonime që i kërcënonte jetën e saj. Letra që i ishte vënë nën derën e banesës së saj, shkruante: “Të lutem mos e mbroj turpin. Në të kundërtën do të të vrasim”.



*Aktivistja Nazlie Bala merr pjesë në protestën e RrGGK-së më 8 Mars 2011, duke kërkuar sigurim shëndetësor dhe shërbime më të mira shëndetësore.*

Kërcënimet dhe sulmi i referoheshin paraqitjes së saj në emisionin e Radio Televizionin të Kosovës (RTK) “Në kërkim” (“In Search”) disa ditë më parë, ku ajo kishte avokuar për përfshirjen e personave që kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës në ligjin egzistues për të gjitha kategoritë e viktimave të luftës.

Përmes [letrave](#) dhe deklaratave për shtyp, RrGGK ka shprehur shqetësimin e vet lidhur me sulmin dhe kërcënimet e bëra ndaj Balës. RrGGK ka kërkuar hetim nga Policia e Kosovës, si dhe mbrojtje të menjëhershme për Balën. RrGGK ka informuar publikun që Bala ka qenë një aktiviste e dalluar e të drejtave njerëzore që nga viti 1990. Ajo ka filluar punën e saj si vullnetare për të drejtat e njeriut, duke punuar me Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ). Për 23 vite që nga atëherë, ajo vazhdimisht ka përkrahur dhe fuqizuar gratë.

RrGGK e konsideron sulmin ndaj Balës, një aktiviste e njohur e të drejtave të grave, jo vetëm sulm ndaj asaj, por ndaj të gjitha grave dhe të gjithë burrave që kërkojnë të mbrojnë dinjitetin e grave të mbijetuara të dhunës sesksuale. Kërcënimet e tilla dhe dhuna kurrë nuk do të pengojnë përpjekjet tona për drejtësi të mëtutejshme në Kosovë dhe për të siguruar dinjitet për gratë të mbijetuara të dhunës.

## Qytetarët Protestojnë Komentet Seksiste të Deputetëve

Instituti për Studime në Shoqëri dhe Kulturë “Alter Habitus,” anëtare e RrGGK-së, organizoi një protestë “Kundër Qëndrimin dhe Gjuhës Seksiste të Deputetëve” më 28 Mars, përpara ndërtesës së parlamentit.

Më 14 mars, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi në lexim të parë amandamentin e propozuar që gratë të cilat kanë përjetuar dhunë seksuale të përfshihen në ligjin për personat e prekur nga lufta (shih më lartë). Megjithatë, aktivistet e të drejtave të grave ishin të brengosura nga dëshmitë e disa deputetëve më 14 mars. Gjuha e tyre seksiste

fyen dinjitetin e grave që kanë përjetuar dhunë seksuale dhe ri-viktimizon ato. Në përgjigje të tyre, Alter Habitus i mbështetur nga RrGGK dhe grupi i aktoreve “Have It” organizuan një protestë përpara parlamentit.

“Ne besojmë që fjalimet e disa parlamentarëve ishin ofenduese dhe përlënë për të gjitha gratë.” tha Hana Qena nga “Have It.” “Ne kemi dalë në rrugë për t’iu treguar atyre që nuk është turp të jesh e dhunuar.”

“Have it” performoi një skicë kundër propozimit që një komitet të ekzaminojë gratë për të “verifikuar” që ato kanë përjetuar dhunë seksuale. Aktoret shtypën molla në dërrasa për prerje, duke simbolizuar dëmet që ekzaminimet do t’i shkaktonin shëndetit të grave. Më pas, pjesëmarrësit gjuajtën drejt parlamentit letra me titimet seksiste të parlamentarëve.



*Pas tavolinës së “ekzaminimit” fjala “Turp” është formuar me anë të letrave me deklaratat personale seksiste të bëra nga parlamentarët për gratë që përjetuan dhunë seksuale.*

“Gjuha seksiste e përdorur në parlament është e turpshme.” tha Avni Bytyqi. “Gratë e dhunuara në Kosovë nuk janë turpi ynë, por janë krenaria jonë. Ato kanë nevojë për përkrahje institucionale dhe ligjore, të cilën këta deputetë që ne i kemi zgjedhur fatkeqësisht ende nuk kanë dëshirë të iu ofrojnë, për arsye të panjohura për ne si qytetarë.”

Duke pasur parasysh sulmin fizik ndaj aktivistes Nazlie Bala një natë para protestës, pjesëmarrësit poashtu mbanin letra ku shkruhej: “Ne të gjithë jemi Nazlie Bala!” Ky ishte “një sulm kundër përpjekjeve tona për të kaluar këtë ligj.” tha Eli Krasniqi, njëra ndër organizatorët nga Alter Habitus. “Sulmet dhe kërcënimet nuk do të na ndalin neve.”



*Përpara parlamentit, grupi “Have It” shtyp molla, duke simbolizuar dëmin që mund t’i bëjë ekzaminimi i propozuar shëndetit psikologjik të grave.*


## Dhuro Jetë: Dhuro Gjak, RrGGK Shënon 8 Marsin

RrGGK, e mbështetur nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjaktut (QKTGJ), shënoi Ditën Ndërkombëtare të gruas përmes aksionit në rrugë "Dhuro Jetë: Dhuro Gjak". Më 8 Mars, në mes orës 12:00 dhe 15:00, 37 burra dhe gra dhuruan gjak në Sheshin Nëna Terezë në Prishtinë.

Shënimi i 8 Marsit me një protestë ose aksion është bërë traditë vjetore për RrGGK. Anëtarët e RrGGK vendosën që avokimi i RrGGK-së këtë vit do të fokusohet në çasjen e grave në shërbime shëndetësore kualitative. Qytetarët u ftuan që të dhurojnë gjak (në vend të dhurimit të luleve), duke ndihmuar sistemin e dobët shëndetësorë të Kosovës.

Muzika luhej zëshëm gjithandej sheshit dhe njerëzit që kalonin aty mund të lexonin banerin (e mësipërm) me moton e ngjarjes: "Dhuro Jetë: Dhuro Gjak." Qytetarët dhuruan gjak, duke i dhuruar në këtë mënyrë dhuratën e jetës njerëzve në nevojë. Gratë poashtu sollën me vete anëtarët e familjeve të tyre.

"Pasi që gjendja ime shëndetësore dhe moshë nuk më lejon të dhuroj gjak, kam sjellur me vete sot dy djemtë e mi." tha Fatima Zatriqi, nga Mitrovica Veriore. "Ata mund të dhurojnë gjak dhe të ndihmojnë gratë kosovare."



Harroni lulet: Burra dhe Gra presin për të dhuruar gjak, në Ditën Ndërkombëtare të Gruas në Kosovë.



**Më 8 Mars, Dhuro Jetë:  
Dhuro Gjak!**

**On March 8th, Give Life:  
Give Blood!**

**Povodom 8 Marta, Daruj Zivot:  
Daruj Krv**

"Unë dhuroj gjak rregullisht dhe pasi që kjo është një ditë simbolike për gratë, jam këtu për të shënuar këtë ditë dhe për të shpëtuar jetën e dikujt." shtoi Nexhati, njëri nga djemtë e Fatimas.

Njerëz të tjerë ndaluan nga rruga e tyre e përditshme përmes Sheshit Nëna Terezë, duke ndaluar për të dhuruar gjak.

"Jam studente dhe kaloj në këtë rrugë kur kthehem nga universiteti. E pashë që njerëzit po dhurojnë gjak dhe ndalova për të bërë të njëjtën gjë." tha Iliriana Leci. "Nuk do të më kushtojë asgjë dhe ky gjest human mund të shpëtojë jetën e dikujt."

## RrGGK Mbledh Grupin e Fuqizimit Ekonomik

RrGGK organizoi një punëtori me Grupin Punues për Fuqizimin Ekonomik, më 6 Mars. Punëtorja kishte dy sesione: Fuqizimi Ekonomik i Grave përmes Gjenerimit të të Ardhurave dhe të Drejtat e Femrës mbi Trashëgiminë dhe Pronën.

Në sesionin e parë morrën pjesë 21 anëtare të 17 OJQ-ve anëtare të RrGGK-së. Organizatat anëtare të RrGGK prezantuan punën e tyre drejt fuqizimit ekonomik të grave. Më pas, Besa Shehu, Menaxhere Financiare dhe Administrative e RrGGK-së, hapi diskutimin mbi hapat drejt fuqizimit ekonomik të grave në Kosovë përmes gjenerimit të të ardhurave.

RrGGK prezantoi idenë e mbështetjes së anëtareve të saj për të mbledhur produktet punëdore të anëtareve të saj për shitje. Hapat e propozuar përfshinin: mbledhjen e produkteve punëdore të grave për prezantim; fotografimin e produkteve; dhe mbledhjen e informatave për të hyrat dhe afatet kohore që nevoiten për prodhim. Anëtarët poashtu diskutuan nevojën për të standardizuar produktet për eksport. Ato vendosën që produktet duhet të bazohen në traditë, por edhe të jenë inovative dhe të adaptuara në kërkesat e tregut bashkëkohorë. Anëtarët u pajtuan që të krijojnë një dokumentarë të shkurtër për produktet punëdore të grave, të asistuar nga Albulena Shabani, mtvU Fituese e Bursës Fulbright për Bërjen e Filmave.

Grupi i dytë Punues në "Të Drejtat e Femrës mbi Trashëgiminë dhe Pronën" përfshiu shtatë organizata anëtare të RrGGK-së. Në Kosovë, mentaliteti tradicional, patriarkal dhe njohuritë e pamjaftueshme të qytetarëve, pengojnë implementimin e Ligjit mbi Trashëgiminë dhe



Me mbështetjen e RrGGK, anëtarët tonë si Arta po paraqesin produktet punëdore tradicionale të grave në zyret e zyrtarëve.

Pronën. Pjesëmarrëset diskutuan lirinë dhe stabilitetin financiarë që ky ligj mund të iu jep grave. Fuqizimi Ekonomik i Grave poashtu kontribuon në minimizimin e gjasave që gratë të mund të përjetojnë dhunë.

Anëtares e RrGGK-së diskutojnë ide dhe ndajnë përvoja rreth fuqizimit ekonomik të gruas.



Gjatë punëtorisë, anëtares e RrGGK gjeneruan ide për implementimin dhe zbatimin e këtij ligji. Ato propozuan që RrGGK të përfshijë student të juridikut në monitorimin e gjyqtarëve për të vërejtur nëse ata janë duke e implementuar ligjin. Anëtares poashtu diskutuan organizimin e fushatave vetëdijësuese për të edukuar popullatën lidhur me të drejtat ligjore të grave dhe burrave. RrGGK momentalisht është duke kërkuar fonde për të ndërmarrë iniciativat e rekomanduara nga anëtares.

## Anëtares Marrin Pjesë në Punëtorinë e Shkrimit të Projekt Propozimeve

Për t'iu përgjigjur kërkesave të anëtareve, RrGGK ka organizuar punëtorinë e dytë për Shkrimin e Projekt Propozimeve në Prishtinë më 28 shkurt deri më 2 mars.

"Jam shumë mirënjohëse për RrGGK-në që organizon punëtori të tilla. Ato na ndihmojnë shumë." tha Gjejrone Lokaj, nga Shoqata Iniciativa e Gruas, në Dragash. "Edhe pse Dragashi është larg nga Prishtina, ndihem shumë afër me stafin e RrGGK-së pasi që e di që ato janë gjithmonë aty për të na mbështetur neve." Punëtorja tre-ditore interaktive mbledhi 52 pjesëmarrëse nga OJQ të ndryshme anëtare të RrGGK-së. Ajo mbuloi analizën e problemeve, analizën e objektivave, kornizën logjike, monitorimin dhe vlerësimin.

"Kjo ishte një punëtori shumë e mirë." tha Gjyle Laçaj, nga OJQ Teuta në Prizren. "Është veçanërisht mirë për ne që po shkruajmë një projekt propozim për herë të parë; është mjaft atraktiv dhe i qartë, kështu që lehtë mund ta përcjellë atë."

Punëtorja e Shkrimit të Projekt Propozimeve iu mundësoi anëtareve të RrGGK që të kuptojnë mjetet dhe teknikat e një shkrimi efektiv të projekt propozimeve. Ajo përfshinte sesione interaktive me ushtrime në grupe të vogla, bazuar në përvojat e pjesëmarrësve dhe intereset e tyre organizative për të krijuar ide të projekteve.

"E shoh punën në grup shumë të dobishme." tha Fikrije Ferizi, nga OSHC "ATO" në Vushtrri. "Mendoj që do të jem në gjendje të përcjellë informatat tek kolegët e mi."

Punëtorja poashtu iu ofroi organizatave anëtare mundësinë që të rrjetizohen me njëra tjetrën dhe të identifikojnë fusha të mundshme për bashkëpunime të ardhshme.

"Edhe pse kam përvojë në shkrimin e projekt propozimeve, unë ende marrë pjesë në të tilla punëtori me qëllim që të ndajë përvoja me OJQ të tjera." tha një anëtare e "Legjenda" në Viti. "Poashtu, donator të ndryshëm kanë kërkesa të ndryshme për projekt propozime dhe trajnerë të ndryshëm kanë mënyrat e tyre të shpjegimit."



Anëtares e RrGGK-së marrin pjesë në një punëtori tre-ditore interaktive për shkrimin e projekt propozimeve.



Myzaferre Ibishaga nga Forumi i Iniciativës së Grave prezanton idenë e projektit të grupit të saj.

Punëtorja ishte organizuar në kuadër të Programit të Ngritjes së Kapaciteteve të RrGGK-së. Ishte financuar nga Austrian Development Agency (ADA), si vazhdimësi e punëtorisë së parë të organizuar në dhjetor të vitit 2012.

Punëtorja ka kontribuar në mënyrë substanciale në aftësinë e organizatave të grave për të shkruar projekt propozime. Kjo ishte veçanërisht e dukshme gjatë krahasimit të projekt propozimeve të dorëzuara në raundin e dytë të Fondit të Grave të Kosovës me ato të dorëzuara në vitin 2012.

RrGGK planifikon të mirëpresë mundësi mujore të zhvillimit të kapaciteteve për anëtares e saj përgjatë vitit 2013, bazuar në nevojat e tyre të identifikuara.